

# Punonjësi juaj i pavarur rishikues



**Broshurë për fëmijë dhe të rinj të moshës 12 vjeç e sipër**

**Albanian**

Kjo broshurë sqaron se si Shërbimi social për fëmijë i Këshillit bashkiak të Kent-it planifikon përkujdesjen ndaj jush dhe se si punonjësi juaj i pavarur rishikues e rishqyrton dhe monitoron këtë plan me ju dhe persona të tjerë që punojnë me ju.

## Plani i juaj i përkujdesjes

Plani i juaj i përkujdesjes parashtron me shkrim hollësira rreth përkujdesjes ndaj jush, përmbushjes së nevojave tuaja dhe rreth personave përgjegjës. Gjithashtu, aty paraqitet se çfarë duhet të prisni ju nga ky plan, si dhe çfarë pritet nga ju.

Plani juaj i përkujdesjes përfshin:

- Kush do të kujdeset për ju (vendbanimi)
- Shkollën apo kolegjin ku do të shkoni
- Mbarëvajtjen e shëndetit tuaj
- Mundësitë për të kryer aktivitete argëtuese, si hobi apo sport
- Kur dhe ku mund të takoni persona të familjes apo persona të tjerë të rëndësishëm për ju
- Mundësitë për të praktikuar fenë apo aspekte të kulturës etnike
- Aspektet ligjore
- Çfarë pritet në të ardhmen

Plani juaj i përkujdesjes parashikon edhe se çfarë pritet të ndodhë nëse ky plan nuk funksionon, dhe që quhet plani kontigjent.

Punonjësi juaj social dhe manaxheri i tij janë përgjegjës për planin e përkujdesjes. Ata duhet t'ju dëgjojnë me vëmendje dhe të marrin në konsideratë dëshirat dhe ndjenjat tuaja, opinionet e prindërve tuaj, si dhe të bashkëpunojnë me persona që janë të përfshirë në kujdesin ndaj jush, si p.sh. mësuesit.

## Takimet rishikuese



Këta takime duhet të mbahen rregullisht nga Shërbimet sociale për të gjithë të rinjtë nën përkujdesje. Takimet rishikuese janë për t'u siguruar që të gjithë po i përmbahen planit të përkujdesjes, si dhe për të parë nëse të gjithë janë të kënaqur dhe për të planifikuar për të ardhmen.

### Personat e ftuar në takimet rishikuese

Ky takim është për ju, kështu që prania juaj është e rëndësishme, në mënyrë që të gjithë të marrin në konsideratë mendimet tuaja rreth vendimeve që merren.

Persona të tjerë që mund të jenë të pranishëm:

- Prindërit apo të afërm të tjerë të familjes
- Kujdestarët
- Punonjësi/punonjësja juaj social/e
- Mesuesi apo mesuesja juaj
- Punonjësi social i kujdestarëve foster
- Kujdestari prind i fëmijës
- Infermieri/infermierja nga shkolla apo e Fëmijëve nën kujdes
- Punonjësi i Pavarur Rishikues (PPR)
- Të rritur të tjerë që punojnë me ju
- Ndonjë visitor i pavarur përkrahës

Ju duhet të pyeteni më parë se kush të ftohet, ashtu si dhe kë nuk doni të jetë në takim. Ju mund të kërkonit këdo tjetër që dëshironi për të qenë i pranishëm në takim.

## **Ku mbahet takimi rishikues?**

Ju duhet të pyeteni se ku dëshironi që të mbahet takimi. Ai mund të mbahet në banesën tuaj, tek shkolla juaj apo tek zyra e punonjësit social.

## **Sa shpesh do të mbahen takimet rishikuese?**

Takimi i parë do të mbahet brenda katër javëve të para pasi jeni vënë nën kujdesje. Takimi i dytë mbahet jo më vonë se tre muaj pas të parit, dhe pastaj do të ketë një takim çdo gjashtë muaj, për sa kohë të mbeteni nën kujdesje.

Në rast se ka ndonjë ndryshim të planit të përkujdesjes ose gjërat nuk po shkojnë si duhet, do të mbahet një takim rishikues. Edhe ju vetë mund të kërkontë takim rishikues, nëse e shihni të arsyeshme.



## Punonjësi i pavaruar rishikues (PPR)

Çdo fëmijë dhe adoleshent nën perkuqdesje duhet të ketë një PPR. Puna e tyre është që të:

- Drejtojnë takimin rishikues
- Sigurohen që plani i kujdesjes është i ai që duhet.
- Sigurohen që të gjithë dëgjojnë dhe marrin në konsideratë mendimet tuaja para se të marrin vendime
- Sigurohen që të gjithë të shprehin mendimet e tyre
- Sigurohen që secili të kryejë detyrën e vet sipas planit
- Sigurohen që egzistojne plane për të ardhmen tuaj
- Sigurohen që ju e dini se si të ankoheni

Gjate rishikimit të Planit tuaj të perkuqdesjes PPR-ja do të dojë të dijë rreth gjërave që kanë shkuar mirë, si dhe rreth problemeve që mund të keni pasur, me qëllim për t'ju ndihmuar dhe përkrahur për zgjidhjen e tyre.

PPR-ja juaj do të dojë t'ju takojë para takimit, për t'ju sqaruar qëllimin e takimit dhe për të dëgjuar opinionet tuaja përpara takimit. Kjo do t'ju japë mundësinë për të treguar se për çfarë doni të flisni, si dhe gjëra që nuk keni dëshirë t'i diskutoni në takim.

## Prania juaj në takimin rishikues

Ju duhet të jeni pjesë e çdo vendimi për të ardhmen tuaj. Nëse e keni të vështirë të flisni gjatë takimit, mund t'i thoni dikujt të flasë në emrin tuaj. Nuk keni nevojë të rrini aty gjatë gjithë takimit dhe mund merrni një pushim kur të doni. Flisni me punonjësin social, kujdestarin apo PPR-në dhe ata do ta mundësojnë këtë gjë për ju.

Juve do t'ju jepet ndihma dhe përkrahja e duhur si p.sh. një përkthyes apo mjete të tjera komunikimi.

Nëse vendosni të mos shkoni në takimin rishikues, mund të flisni me kujdestarin apo punonjësin social, ose me dikë të cilit i besoni. Nëse doni, ju mund të shkruani çfarë keni për të thënë në takim dhe PPR-ja juaj mund t'i lexojë këto shënime gjatë takimit, në emrin tuaj.

## Përgatitja për takimin rishikues.

Para takimit juve do t'ju jepet një formular konsultimi ku mund të shënoni gjërat që doni të thoni. Po ashtu, ju mund të bëni një listë apo mund të dërgoni një tekst rreth gjerave që doni të thoni. Nëse doni ta drejtoni ju takimin apo qoftë edhe pjesërisht, punonjësi social apo PPR-ja do t'ju përkrahin.

## Pas takimit rishikues

Punonjësi juaj social, kujdestari apo PPR-ja do të bisedojnë me ju pas takimit për t'u siguruar që ju e keni kuptuar se çfarë është biseduar dhe vendimet që janë marrë. Nëse nuk jeni dakord me ndonjë nga vendimet e marra, ata do të sigurohen që ju t'i kuptoni arsyet.



## Si të bëni ankesë

Në rast se nuk jeni dakord me ndonjë nga vendimet e marra, ju mund të flisni me kujdestarët dhe me punonjësin social, si dhe mund të kontaktoni PPR-në. Nëse përsëri vazhdoni të jeni të pakënaqur, ju mund të bëni ankesë.

Për të kryer një ankesë apo për informacion të mëtejshëm kontaktoni:

Shërbimi për rishqyrtim të pavaruar:

- Veri/Perëndim

Worrall House  
30 Kings Hill Avenue  
West Malling ME19 4AE

Tel: 03000 421543  
email: [IROServiceNW@kent.gov.uk](mailto:IROServiceNW@kent.gov.uk)

- Jug/Lindje

Brook House  
Reeves Way, John Wilson Business Park  
Whitstable CT5 3SS

Tel: 03000 421544  
email: [IROServiceSE@kent.gov.uk](mailto:IROServiceSE@kent.gov.uk)

Përkrahës dhe vizitorë të pavarur: `

- Young Lives Foundation

71 College Road  
Maidstone ME15 6SX

Tel: 01622 683815  
email: [advocacy@ylf.org.uk](mailto:advocacy@ylf.org.uk)

